



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Tiranë më, 3 korrik 2017

Thirrje për pjesëmarrje në konkurrimin për Kryetar i Akademisë së Shkencave

Mbështetur ligjit Nr.9655, datë 11.12.2006 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, Neni 11 “Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë” (ndryshuar me ligjin Nr.9853, datë 26.12.2007, neni 7); Statutit organik të saj, neni 17 dhe neni 18; “Kodit evropian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor” ; në përfundim të mandatit katër vjeçar të kryetarit aktual;

Sa më sipër, ftojme kandidatët me titullin “akademik” (i rregullt ose i përhershëm), për aplikim përmes kësaj thirrjeje publike për pjesëmarrje.

I. Sipas procedurës së parashikuar të aplikimit, kandidatët duhet të paraqesin në protokollin e Akademisë së Shkencave:

1. Kërkesë personale për aplikim drejtuar zyrtarisht asamblesë së Akademisë së Shkencave.
2. CV-në, listën e punimeve dhe fotokopjen e kartës së identitetit/pasaportës, që vërteton se kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare.
3. Platformë për drejtimin e Akademisë së Shkencave në katër vitet e ardhshme.
4. “Formular Aplikimi për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” . (sipas nenit 29, pika 1, gërma gj, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”).
5. “Formular vetëdeklarimi”, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar sipas ligjit Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Formularët gjenden në webin e Akademisë së Shkencave:
<http://akad.gov.al/ash/legjislacioni/formular-vetedeklarimi>

7. Periudha e aplikimit është nga data 3 korrik 2017 deri në datën 17 korrik 2017.
8. Mbledhja e asamblesë për votimin e kandidaturave do të zhvillohet më 4 shtator 2017, ora 11.00 në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave.



II. Procedura e përzgjedhjes dhe votimit

1. Kryetari i Akademisë duhet të jetë anëtar i rregullt ose i përhershëm i Akademisë.
2. Zgjedhja e tij bëhet nga Asambleja drejtpërdrejt dhe me votim të fshehtë, pa debat.
3. Quhet i zgjedhur akademiku që fiton shumicën e cilësuar absolute (50%+1) të votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë.
4. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton shumicën e cilësuar absolute të votave të anëtarëve të Asamblesë, votimi përsëritet, duke qenë kandidatë dy akademikët që kanë marrë më shumë vota.
5. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk arrin të fitojë shumicën absolute të votave zbatohet parimi i shumicës së thjeshtë (jo më pak se 50%+1) të anëtarëve të pranishëm të Asamblesë.
6. Mandati në detyrë është 4 vjeçar dhe fillon ditën e zgjedhjes nga Asambleja. Nuk mund të kandidosh dy herë rresht për këtë pozicion.
7. Kryetari i zgjedhur i Akademisë emërohet me dekret të Presidentit të Republikës.

III. Detyrat e Kryetarit sipas rregullores së brendshme të ASH-s

KREU III

Funksionet Drejtuese

Neni 7

Kryetari

Kryetari është titullari i Akademisë së Shkencave i zgjedhur nga Asambleja e ASH-së dhe i dekretuar nga Presidenti i Republikës. Ai drejton Asamblenë e Përgjithshme, Kryesinë, Këshillin Ekzekutiv dhe Këshillin e botimeve. Kryetari ushtron detyrat dhe funksionet e tij të përcaktuara nga ligji "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", nr. 9655, dt. 11. 12. 2006 të ndryshuar, në Statutin e ASH-së dhe në këtë rregullore:

-Përfaqëson ASH në marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe të shteteve të tjera;

-Drejton organizmat e Akademisë dhe ndjek veprimtarinë e tyre;

-Mban lidhje me organet e larta shtetërore dhe organizma të tjera dhe përfaqëson Akademinë në to;

-Përfaqëson Akademinë në të gjitha marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe me institucionet analoge jashtë vendit;

-Thërret dhe drejton mbledhjen e Asamblesë së Akademisë, Këshillit Ekzekutiv dhe Këshillit të Botimeve;

-Për mbarëvajtjen e punës, kryetari i Akademisë shprehet me vendime për të gjitha çështjet që kërkojnë akt nënligjor;

-Miraton "Kalendarin vjetor të aktiviteteve dhe veprimtarive shkencore të ASH-së";

-Miraton planin e botimeve vjetore;



-Kryetari i Akademisë në të gjithë veprimtarinë e tij dhe ushtrimin e funksionit ndihmohet nga zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor. Në rast mungese, ai autorizon njërin prej tyre për ta zëvendësuar në të gjitha funksionet e tij për një periudhë të caktuar;
-Kryen veprimtari kërkimore shkencore vetjake.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

